



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 07, Datë 22.01.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.299, DATË 19.10.2023, PËR  
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE SHOQËRISË “TRUEN” SH.P.K. PËR  
NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 115 prot., datë 11.01.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 299, datë 19.10.2023, për dhënie autorizimit nga ERE shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 299, datë 19.10.2023 ndër të tjera ka vendosur: (1) Dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TRUEN”sh.p.k.; (2) Ortaku i vetëm i shoqërisë “TRUEN”sh.p.k. bëhet “YLLIAD”sh.p.k.; (3) Brenda datës 31.12.2023, shoqëria “TRUEN”shpk duhet të depozitojë në ERE miratimin me shkrim të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a për lirimin pa asnjë rezervë dhe asnjë kusht të kuotave të saj; (4) Dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TRUEN”sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe; (5) Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit nga ana e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.
- ERE me shkresën nr. 1959/12 prot., datë 15.12.2023 kujtoi shoqërinë “TRUEN” sh.p.k. që të depozitojë dokumentacionin për sa lënë kusht në vendim nr. 299/2023, brenda datës 31.12.2023.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1959/13 prot., datë 26.12.2023 depozitoi deklaratën noteriale me nr. 2507 Rep., nr.1767 Kol., datë 05.12.2023 të Bankës Kombëtare Tregtare ku kjo e fundit deklaroi se Përfituesi/BKT, heq dorë nga barra siguruese mbi Kuotat e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. dhe çdo të drejtë tjetër mbi kuotat e kësaj shoqërie, meqenëse

Kredia për sigurimin e të cilës këto kuota janë bllokuar, është shlyer plotësisht nga Kredimarrësi ,shoqëria “TRUEN” sh.p.k.

- Me depozitimin e kësaj deklarate, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3, si e tillë nuk gjen më zbatim as pika 5 e vendimit të bordit nr. 299/2023, ndaj vlerësohet që pika 3 dhe 5 të shfuqizohen.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 3 dhe 5 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 299, datë 19.10.2023, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “TRUEN” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**